



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 129, datë 27.07.2023



PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1 BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 71, DATË 12.07.2022, “PËR MIRATIMIN E LISTË SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, PALLATI NR.8, RRUGA “TELAT NOGA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, Raportit me nr. 3103/2 prot., datë 19.07.2023 të Komisionit të Posaçëm si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e disa shtesave në Aneksin 1 bashkalidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 12.07.2022, i ndryshuar, përta i përket listës së përfituesve për Pallatin Nr.8, Rruga “Telat

Noga”, në Njësinë Administrative nr.4, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas tabelës, si më poshtë vijon:


Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
19	VATHE KARAMANI, TAJAR KARAMANI, SHAHIN KARAMANI, MIMOZA KARAMANI, NAZIM KARAMANI, VJOLLCA KARAMANI	4	2+1
20	SOSE NAZIFI, KRISTINA VEZI, ARBEN NAZIFI, NEXHMIJE NAZIFI, BAHRI NAZIFI, NAZE NAZIFI	5	3+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 28.07.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 525/prot.
16

Durrës, më 31 . 07 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.129 datë 27.07.2023 “Për miratimin e disa shtesave në aneksin 1 bashkalidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 12.07.2022, “Për miratimin e listë së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative nr.4, pallati nr.8, rruga “Telat Noga”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, i ndryshuar.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI